

## EDITORIALI

### Puna vazhdon

Arsim Canolli  
Kryeredaktor  
[arsim.canolli@uni-pr.edu](mailto:arsim.canolli@uni-pr.edu)

Këtë vit, antropologjia në Kosovë ka zënë hap të mirë. Në tetor 2024, Universiteti i Prishtinës themeloi Institutin e Antropologjisë (IAUP), i cili do të funksionojë pranë Departamentit të Antropologjisë dhe brenda Fakultetit Filozofik. Ky institut synon avancimin e hulumtimeve antropologjike përmes bashkëpunimeve me partnerë lokalë, rajonalë dhe ndërkombëtarë. Gjithashtu, në shtator 2024, Departamenti i Antropologjisë organizoi konferencën e INASEA-s (Shoqatës Ndërkombëtare për Antropologji të Evropës Juglindore), ku mbi 100 studiues nga vende të ndryshme paraqitën punimet e tyre mbi migrimin, nën temën “*Brenda, jashtë dhe ndërmjet: Migrimi transnacional dhe i brendshëm në Evropën Juglindore.*” Po ashtu, ky vit kulmoi me hapjen e Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe më 26 mars 2024, në 25-vjetorin e masakrës në fshatin Krushë e Madhe, ku 241 shqiptarë (përfshirë 14 ashkalinj) u masakruan dhe u zhdukën. Muzeu qëndron si një tribut solemn për jetët e humbura gjatë masakrës dhe shërben si një hapësirë kyçë për ruajtjen e kujtesës së këtij kapitulli të errët të historisë së Kosovës. Hapja e i tij ishte rezultat i katër vjetëve të bashkëpunimit të palodhur midis antropologëve (profesorë dhe studentë) dhe partnerëve të ndryshëm lokalë dhe ndërkombëtarë.

Fjala “zbulim” i shkon shtati më së miri arkeologjisë. Megjithatë, përderisa zbulimi zakonisht i referohet një ngjarjeje të veçantë, gjermimi arkeologjik në vetvete është një proces i gjatë dhe i vazhdueshëm, i ngjashëm me udhëtimin apo gjakimin. Arkeologët kosovarë vazhdojnë udhëtimin e tyre, duke zbuluar evidenca të reja, si mozaikët në kishën paleokristiane, së bashku me mbishkrimin e famshëm dedikues të perandorit Justinian, i zbuluar vitin e kaluar në parku arkeologjik të Ulpianës. Është e rëndësishme të theksohet se bashkëpunimi ndërkombëtar ka pasuruar ndjeshëm udhëtimin tonë arkeologjik në Kosovë. Në vitet e fundit, partneritetet me Ecole Normale Supérieure në Francë, Universitetin e Michiganit në SHBA, si dhe kolegë nga Shqipëria, Gjermania, Italia dhe Maqedonia e Veriut, kanë avancuar kërkimet arkeologjike.

Në këtë vëllim të revistës *Kosova Anthropologica*, redaksia përzgjodhi katër artikuj të shqyrtuar nga kolegët përmes procesit “peer-review”. Këto kontributë rrokin tema të ndryshme, si analiza kimike e tokës në Ulpianë për të interpretuar aktivitetet historike, studime të hershme karpologjike që zbulojnë praktikat bujqësore në Dardaninë romake,

ndikimet e hershme keltike në Italinë Veriore dhe në Adriakun e Epërm si dhe rolin e migrantëve të kthyer në zhvillimin rural të Kosovës.

Studimi i parë, i drejtuar nga Arthur Laenger dhe ekipi i tij, shqyrton përdorimin e analizës kimike të tokës në Ulpianë për të identifikuar aktivitete të kaluarën. Duke përdorur metodën EDXRF, një teknikë më ekonomike krahasuar me ICP-MS, hulumtimi dha prova të gropave për përgatitjen e gëlqeres dhe një punëtorie për riciklimin e bronxit. Koncentrimet e larta të kalciumit dhe strontiumit në gropë sugjerojnë praninë e materialeve ndërtimore, ndërsa metalet si bakri, hekuri dhe plumbi tregojnë për aktivitetet metalurgjike. Gjithashtu u identifiku një element i spikatur, bromi, i cili mund të lidhet me ngjyrat prestigjioze të tekstit që përdorën elitat romake. Ky studim thekson potencialin e analizës kimike në interpretimin e strukturave arkeologjike dhe nxit zgjerimin e kësaj metodologjje në vende si *Justiniania Secunda*.

Florian Jedrusiak paraqet një studim karpologjik që fokusohet te praktikat bujqësore të hershme në Ulpianë, duke ofruar njohuri mbi ekonominë bimore dhe traditat ushqimore midis shekujve I dhe VI pas Krishtit. Duke analizuar mbetjet e bimëve të karbonizuara, studimi identifikoi kulturat vendore si gruri, orizi, misri dhe perimet, bashkë me frutat e egra si rrushi, arrat dhe shtogu. Mungesa e ushqimeve të importuara sugjeron se paska ekzistuar një sistem bujqësor i vetëmjaftueshëm. Një zbulim i veçantë ishte përdorimi i vazhdueshëm i bishtajës së hidhur, një veçori unike e Ballkanit gjatë kohës romake. Ky hulumtim krijon një bazë për studime të mëtejshme për praktikat bujqësore në Dardaninë e lashtë.

Hulumtimi i Linda Papit thellohet te prania e hershme të komuniteteve kelte në Italinë Veriore dhe Adriatikun e Epërm para migrimeve të shekullit IV p.e.s. Studimi gjurmon dëshmitë arkeologjike, duke përfshirë fibulat, armët dhe objektet metalike, dhe nxjerr në pah ndërveprimet midis kulturave vendase dhe asaj kelte qysh në shekullin VII p.e.s. Në vend që të fokusohet vetëm te migrimet masive, ajo shqyrton shkëmbimet kulturore, lëvizshmërinë individuale dhe përvetësimin e elementeve kelte nga komunitetet vendëse. Këto gjetje, si integrimi i objekteve me stil kelt si simbole statusi dhe mallra tregtare, hedhin dritë mbi dinamikat kulturore të Epokës së Hekurit në kontekstin evropian.

Së fundi, Lumnije Kadriu hulumton ndikimin e migrantëve të kthyer në zhvillimin rural në Kosovë. Duke u përqendruar në tri raste të migrantëve të kthyer nga Gjermania, Zvicra dhe Sllovakia, studimi vë në pah se si individë me aftësi profesionale të kufizuara arritën të themelonin biznese të suksesshme në bujqësi, prodhim organik dhe verëtari. Duke shfrytëzuar kapitalin financiar dhe social të fituar jashtë vendit, këta të kthyer jo vetëm që përmirësuan statusin e tyre social, por edhe kontribuan në zhvillimin lokal dhe krijimin e vendeve të punës. Studimi thekson rolin e rrjeteve transnacionale dhe familjare në lehtësimin e riintegrimit të suksesshëm dhe të ndërmarrësisë në zonat rurale të Kosovës.

Në përgjithësi, punimet në këtë vëllim nënvisojojnë qasjet e ndryshme dhe inovative në antropologji kulturore dhe arkeologji, duke dëshmuar hapat e rëndësishëm që po bën Kosova në avancimin e njohurive antropologjike mbi të kaluarën dhe të tashmen.